



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 20.2.2025

Nr: 121

Ora: 13:00

**VENDIM**

**PËR**

**LIRIMIN DHE EMËRIMIN E SEKRETARIT TË KZAZ NR. 64, QARKU BERAT, TË  
PROPOZUAR NGA PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET  
PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V Ë R E J:**

Partia Demokratike ka depozituar pranë KQZ shkresën nr. 1143 Prot., datë 20.02.2025, duke kërkuar lirimin dhe emërimin e sekretarit të KZAZ nr. 64, Qarku Berat.

Propozimi dhe kandidatura e paraqitur plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S:**

1. Lirimin nga detyra të sekretarit të KZAZ-së nr. 64, Qarku Berat, zj. Ronje Vladimir Dhembo, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Emërimin e sekretarit të KZAZ-së nr. 64, Qarku Berat, z. Kristostom Proko, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 20.2.2025 Nr: 121  
Ora: 13:00



“Për lirimin dhe emërimin e sekretarit të KZAZ-së nr. 64, qarku Berat, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”